

AKT THEMELIMI

I Shoqërise me Përgjegjësi të Kufizuar
"HOTEL VOSKOPOJA" Sh.P.K



Ne Tirane, sot me date 16/06/ 2022, me cilesine e "Ortakut të Vetem Themelues":

Venera Kalivopulli, e bija e Dhimitraqit e datelindjes 07.09.1978, lindur ne Tirane e banuese ne Gjirokaster, shtetase shqiptare, madhore, me zotesi te plote per te vepruar, identifikuar nepermjet leternjoftimit ID me nr. 036419638, e cila ne respektim te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008, " Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare ", i ndryshuar me ligjin 129/2014, ligjit 9723, date 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", hartoi aktin e themelimit, te shoqërise me përgjegjësi të kufizuar, me emertimin "HOTEL VOSKOPOJA" Sh.P.K

KREU I

Neni 1

Krijimi Shoqërise

Shoqëria "HOTEL VOSKOPOJA" Sh.P.K është person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqëria").

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria "HOTEL VOSKOPOJA" Sh.P.K është një shoqëri tregtare, e themeluar nga "ortaku", i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaku gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

Ortaku i vetem themelues i shoqërise mbeshtetur ne ligjin nr.9062 date 08.05.2003 "Kodi i Familjes", neni 72, është ne regjim pasuror martesore te ndare, sipas "Marreveshja Martesore per

ndarjen e pasurise" me nr. 2175 REP. e nr.656 KOL. Date 07.12.2006; nr. 858 REP.e nr. 512 KOL. Date 12.11.2008. te Noterit Bujar Xhaxho Gjirokaster si dhe "Deklarates Noteriale" me nr. 3091 REP. e nr. 925 KOL. Date 29.07.2011 te Noteres Majlinda Lleshi Tirane.



Neni 3

Selia e Shoqerise

Shoqeria e ka seline ne Voskopoje " Bashkia Korce, Njesia Administrative Voskopoje me Nr. Pasurie 1029/33, Shqiperi.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendimin e ortakut.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

Shoqeria do te ushtroje te gjitha aktivitetet te lejuara nga ligji, duke perfshire :

1. Aktivitete te agroturizmit dhe zhvillimit rural, restorante dhe te ngjashme, hoteleri dhe te ngjashme. Merr, trajton, magazinon, ruan, perpunon dhe prodhon, tregton, blen, shet dhe merret me cdo menyre ose mjet tjeter te produkteve bujqesore dhe blektorale. Te ushtroje aktivitet ne fushen e prodhimit dhe perpunimit, ambalazhimit, marketimit dhe tregtimit te produkteve blegtorale, bujqesore, shtazore dhe e te gjitha derivateve te tyre. Te kryej cdo veprim tjeter qe lidhet me prodhimin, perpunimin dhe tregtimin ne fushen e produkteve bujqesore, shtazore dhe blegtorale ne teresi, ne perputhje te plote me legjislacionin Shqiptare ne fuqi.
2. Mbareshtimi blegtoral te imeta dhe te trasha, mbareshtim dhe prodhim bletesh.
3. Prodhim ambalazhim tregtim uji natyral, lengje frutash, pije freskuese, birrari etj.
4. Prodhim dhe tregtim te bylmeteve.
5. Prodhim ambalazhim tregtim te pijeve te ndryshme alkolike, likerave, receleve etj.
6. Prodhim perpunim dhe tregtim te mishit dhe nenprodukteve te tije, si sallame, proshute etj.
7. Prodhim, Grumbullim, tregtim te bimeve dhe frutave natyrale, mjekesore dhe perpunimin e tyre ne barna popullore etj.

8. Shoqeria mund te kryje edhe veprimtari te tjera ndihmese te cilat mbeshtesin arritjen e qellimit te saj kryesor ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Mund te kryje cdo operacion financiar, tregtar, sherbimi, industrial, importe dhe eksporte, me pasuri te luajtshme ose te paluajtshme.
9. Ushtrim veprimtarie ne fushen e rikonstruksioneve ndertimore , ndertim etj.
10. Shoqeria ka te drejte te mundesoje trajnime profesionale per palet e treta. Dhenie marrje me qera si dhe cdo aktivitet tregtar. Te vendose pengje ose barre hipotekore, te aplikojte prane projekteve dhe programeve te ndryshme si brenda ashtu edhe jashte vendit per te perfituar fonde, financime, kredi etj. per te arritur qellimet e shoqerise.
11. Shoqeria mund te zoteroje kuota/aksione etj ne shoqeri te tjera pavarsisht llojit dhe veprimtarise ne te cilen operojne ato shoqeri.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKB.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000(nje qinde mije) lekë.

-Kapitali i shoqerise perbehet nga Nje(1) kuote me vlere nominale sejcila kuot 100.000lek.

-Kapitali themeltare i shoqerise do te paguhet pas regjistrimit te shoqerise ne QKB .


-Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta) .

-Sipas kontributeve te mesiperme Znj. Venera Kalivopulli i perket 1 kuote, qe i korespondon 100% e kuotave te kapitalit te shoqerise .

-Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 7


Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit



Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe ne sherbime, nepermjet emerimit te nje eksperti te rregjistruar per keto kontribute ne natyre.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të ortakut në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".



Neni 8

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të tij ne Qendren Kombetare te Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakut te Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakut te Vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miratone cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Asambleja e Ortakut te Vetem, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrshtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 10

Administrimi

Administrator i shoqerise eshte Venera Kalivopulli, e bija e Dhimitraqit, e datelindjes 07.09.1978, lindur ne Tirane e banuese ne Gjirokaster, shtetase shqiptare, madhore, me zotesi te plote per te vepruar, identifikuar nepermjet leternjofimit ID me nr. 036419638, meafat nga data 16.06.2022 deri me 16.06.2027.

Administratori i shoqërisë do të ushtrojë kompetencat e administrimit për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërteritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë. Administrator i shoqërisë mund të emërohet edhe një person i tretë jashtë ortakërisë.

Neni 11

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga vendimi i ortakut;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara ortakut për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarrëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgoj të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakut edhe në rastet kur :

sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuar brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të tij, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e

juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, Bankave të gjitha niveleve, zyrave të tatim taksave, autoriteteve doganore, përfshi këtu edhe autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12

Përgjegjësitë

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Ortaku i shoqërisë që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimitarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale,

sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:


a) kthen ortakut kontributet;

b) paguan ortakut interesa apo dividendë;

c) i shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.



Neni 13

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 14

Bilanci i shoqërisë dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblese së Ortakut të Vetem të Shoqërisë, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Asamblese së Ortakut të Vetem vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislativës shqiptare.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 16

Dispozita perfundimtare

Ky Akt themelimi i shoqerise "HOTEL VOSKOPOJA" Sh.p.k u redaktua me vullnetin te lire e te plote te "ortakut themelues", ne 4 ekzemplare me vlere te njejta juridike ne gjuhen shqipe

ORTAKU

VENERA KALIVOPULLI

Venera Kalivopulli



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER SONILA A. XUKTHI



DATE 16/06/2022
NR REP 1266



VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 16/06/2022, para meje Notere SONILA A. XUKTHI, anëtarë në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.5, EMIN DURAKU, NR.52, NR:1, NR.4, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUES/IT:

Venera Kalivopulli, atësia Dhimitraq, amësia Zhulieta, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banues në GJIROKASTËR, me adresë Gjin Zenebisi 01980039; Nd. 79; H. 1; Gjirokastër; Gjirokastër; 6001; Gjirokastër; lindur më 07/09/1978, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 036419638 dhe nr. personal H85907020J, .

Subjekti i mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitë dhe nënshkroi përpara meje Noteres, "Statutin dhe aktin e themelimit te shoqerise HOTEL VOSKOPOJA ", bashkëlidhur.

Unë Noter/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

SONILA A. XUKTHI

